



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL¹

(I përmbledhur)

Tiranë, më 28.03.2019, ora 17.00

Drejton mbledhjen -

Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit

Rendi i Ditës :

1. Diskutimi dhe miratimi i Projektvendimit për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Marrin pjesë² :

- | | |
|-----------------------|----------------------|
| 1. Ardian Dvorani | (kryetar) |
| 2. Vitore Tusha | (zëvendës kryetare) |
| 3. Arta Marku | (anëtare) |
| 4. Fatri Islamaj | (anëtar) |
| 5. Margarita Buhali | (anëtare) |
| 6. Eriol Roshi | (anëtar) |
| 7. Medi Bici | (anëtar zëvendësues) |
| 8. Gurali Brahimllari | (anëtar zëvendësues) |

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (*neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c"*) dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (*neni 17*), referuar pengesës ligjore për të bërë publike qëndrimet dhe diskutimet e plota të vetë anëtarëve të KED, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

² Anëtarja e Fatjona Memçaj nuk merr pjesë në diskutimin dhe miratimin e akteve nënligjore normative, për shkak të papajtueshmërisë-marrëdhënie krushqie e afërt me kandidaten Ardita Alsula. Sipas ligjit, Kryetari i Këshillit e ka miratuar heqjen dorë me vendimin nr.1 datë 14.02.2019.

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :

1. Enio Haxhimihali, përfaqësuesi i Avokates së Popullit.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016 :

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga institucionet ndërkombëtare, mbështetëse të procesit të hartimit të akteve nënligjore të KED :

1. Agnes Bernhard, shefe e misionit EURALIUS
2. Julinda Beqiraj, ekspert i EURALIUS,
3. Maniela Sota, Koço Bendo, përkthyes për EURALIUS

HAPET MBLEDHJA

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

Në mbledhje nuk merr pjesë anëtarja zëvendësuese e Këshillit, zonja Klodiana Veizi (Mema), i cili, sipas njoftimit, e ka të pamundur pjesëmarrjen për shkak të problemeve shëndetësore familjare.

Ardian Dvorani lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

Diskutimi dhe miratimi i Projektvendimit për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

Anëtarët e Këshillit miratojnë rendin e ditës së programuar.

Këshilli vijon mbledhjen me pjesën tjetër të dispozitave të pashqyrtuara të projektvendimit normativ *Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*

Anëtarët e Këshillit në vijim të diskutimeve të gjata në mbledhjen e kaluar për pikën 66 të projektaktit, lidhur me njoftimin e organit të emërtesës për papërshtatshmërinë e kandidatit

nëse vlerësohet më pak se 60% të pikëve për secilën meritë, me mendimin kundër të **Kryetarit Ardian Dvorani**, e vendos që kjo dispozitë të hiqet nga projektakti.

Anëtarët e Këshillit nisur nga diskutimet në parim në mbledhjet e mëparshme lidhur me rregullin e preferencës së shprehur nga kandidati për përzgjedhjen e tij në njërin nga vakancat ku ka paraqitur interes, **Anëtarët e Këshillit** vendosën të hiqet edhe pika 67 nga projektakti.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 68 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 69 të projektaktit dhe diskutojnë për nevojën e qartësimit të rregullave në këtë dispozitë dhe më tej mbi mënyrën e caktimit të pikëve nga secili anëtar që finalizohet me shumatoren e pikëve të përbashkëta pjesëtuar me numrin e anëtarëve, mënyrën e arsytimit të përbashkët të vlerësimit në vendim dhe të vlerësimeve e pikëzimit dukshëm të ndryshme të anëtarit për një a më shumë kriteve, për mënyrën e pasqyrit të këtyre qëndrimeve në vendim dhe tabelat e pikëzimit etj. dhe të bërjes publie të tyre.

Bledar Dervishaj kërkon fjalën dhe parashtron se kjo pikë duhet parë në zë njëjtën logjikë me pikën 64 që u shqyrtua pak më parë. Këshilli aty ra dakord për mënyrën e pikëzimit, si shumatoren aritmetike të pikëve të secilit anëtar për pjesëtuar me numrin e anëtarëve. Unë mendoj që tashmë ju vendimin e keni marrë në “dhomë këshillimi” dhe që arsytimi i vlerësimit të secilit nga anëtarët e Këshillit duhet të gjejnë reflektim në procesverbalin e zbardhur. Për gjëra të dakortësuar, unë nuk mendoj se duhet të ketë diskutim. Këtu duhet kujdes që të mos hyjmë në ndikimin e një anëtari tek një tjetër. Avokatja e Popullit e përmendi herën e kaluar. Edhe unë kam qenë pjesë e një strukture të tillë vendimi ku secili anëtar jepte pikët e tij dhe ndonjëherë pikërisht këtu fillon edhe cedimi. Pra kur hyn në diskutime se pse Bledi i dha 3 pikë, pse e mendon ti kështu etj. Sepse këtu trysnia e konkurrimit, e cilësisë së konkurrimit do të bëjnë që diferenca të jetë shumë e vogël, qoftë edhe me një pikë. Është e pritshme. Kështu që mund të ketë paksa ndikim, edhe pa dashje në arsytimin e një anëtari kur dëgjon arsytimin e tjetrit. Kështu që mendoj se shumatorja aritmetike e secilit anëtar është më objektive, e zbardh me procesverbal apo me arsyet që do të dala në vendim dhe në raportin e arsyetuar.

Ndoshta tek projektvendimi i vlerësimit të secilit kandidatë përveç metodologjisë që ju do të përgatisni mund të shtohet një rubrikë e caktuar për vlerësimet ekstreme midis anëtarëve të Këshillit dhe të përshkruaj qoftë edhe se pati vlerësime ekstreme. Pikë minimale nga anëtarë të këshillit u dhanë më këtë arsye dhe për pikët maksimale u dhanë për këtë arsye. Kjo nuk dikton as vendimmarrjen e njërit apo të tjetrit, por është edhe transparenca aty brënda.

Agnes Bernhard (*përkthen përkthyesja*), mbi kërkesën e anëtarëve të Këshillit për të dhënë mendime, merr fjalën dhe parashtron se në qoftë se shikohet kjo si çështje, janë dy

modele. Por të dy modelet janë të mirë, nuk janë të këqinj. Eksperienca ime në organe të tilla ku kam marrë pjesë në shumë raste të tilla është që në qoftë se anëtarët diskutojnë, ata e ndikojnë njëri – tjetrin. Për shkak se ndodh që nëse unë shpreh një qëndrim dhe dëgjoj një tjetër, atëherë e shikoj që ai ka një arsye që e mendon ashtu. Kështu që edhe tek unë kjo mund të ndikojë që ta ndryshoj mendimin. Këtu është e pasqyruar sepse gjithkush ka të drejtën dhe mundësinë që të thotë se përse ka vendosur një numër të caktuar pikësh. Arsyeja kur bëhet publike dhe pozitiviteti në këtë është që kur unë jap arsyetim, atëherë më hiqet kjo mundësia e anësisë sepse unë ndryshe them jap kaq pikë pa e arsyetuar dhe e kam të lehtë. Pra, rritet mundësia për të arritur konsensusin nëpërmjet diskutimit dhe që të mos ketë thjesht votime ekstreme, numra dhe shifra ekstreme për shkak të mungesës së nevojës për ta arsyetuar. Ndërsa, në qoftë se në vendimmarrje reflektohet edhe numri i pikëve që ka dhënë sejcili anëtar kjo shton presionin mbi anëtarët përkatës. Duhet të merret parasysh se duhet të ushtrohet edhe diskrecioni, pra pa e detyruar kënd që të shprehet në mënyrë të sforcuar pse ka dhënë këtë apo atë mendim. Për këto gjëra nuk është se ka receta dhe që mund të shprehesh në mënyrë të prerë. Unë do të isha në favor të transparencës por ka edhe argumenta që janë kundra kësaj.

Enio Haxhimihali kërkon fjalën dhe parashtron se unë do ta shikoj, po të bëj një paralelizëm, me atë që çfarë bën një trupë gjykuese dhe çfarë bën ky organ. Në një trup gjykuese, relatori parashtron çështjen dhe diskutojnë anëtarët e trupës gjykuese. Ndërkohë që në këtë rregullore në themi që relatori në njëfarë mënyre relaton “vendimin” e çdo anëtari. Pra, neni 69 fillon me përfundimin e diskutimit. Do të ketë një diskutim ndërmjet anëtarve pse unë dhashë aq pikë dhe pse ky dha aq pikë. Pra, zonja Agnes, ngriti çështjen e ndikimit të një anëtari tek tjetri. Dhe unë nuk e shikoj këtu. Pra, çdo anëtar, në një farë mënyre e ka marrë vendimin e tij. Dhe këtu nuk diskutohet pse ky anëtar mori këtë vendim kjo është çështja e parë. E rëndësishme është të ruajmë dy parime. Parimi i arsyetimit të vendimit dhe parimi i transparencës. Pra, çdo anëtar, të ketë të drejtën për të pasqyruar në procesverbal atë që diskuton. Më pas do të jetë procesverbali i përmbledhur që do të bëhet publik apo sipas këtij varianti që ti dërgohet Kuvendit dhe Presidentit edhe mendim të tij ndryshe. Pra, heqja e mendimit ndryshe të një anëtari do të ishte një parim jo i pëlqyer.

Anëtarët e Këshillit në përfundim të diskutimeve, vlerësuan të kalojnë me disa vëretje dhe sugjerime përmbajtjen e pikës 69 të projektaktit, për të shprehur në vendim jo vetëm pikëzimin mesatar por edhe të arsyetohet qëndrimi i anëtarëve se përse caktohen këto pikë, të cilat bëhen publike.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë me disa ndryshime përmbajtjen e pikës 70 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit vijojnë me shqyrtimin dhe diskutojnë mes tyre mbi përmbajtjen e pikës 71 të projektaktit, lidhur me dërgimin e dy listave të ndara për kandidatët që vijnë dhe ata që nuk vijnë nga radhët e gjyqësorit kur i njëjti organ emërtese ka dy vende vakante në proces, si duhen kuptuar kandidatë të ardhur nga radhët e gjyqësorit, si edhe lidhur me situatën aktuale kur njëherazi janë në proces më shumë se dy vende vakante për secilin organ emërtese, që aq më tepër janë vakanca të plota apo të pjesshme etj., pra edhe për diskutimin e nevojës për një rregullim kalimtar në këtë projektakt krahas me rregullimin të zakonshëm që përmban kjo pikë 71 e këtij projektakti.

Bledar Dervishaj kërkon fjalën dhe parashtron se kjo kjo dilemë që ka shtruar Këshilli për diskutim ka qenë një ushtrim i vështirë edhe për ne kur e shpallëm vakancën. Përpara se ti shpallnim na është dashur të kuptojmë edhe mënyrën se si do ti shpallim dhe ne kemi ecur me një linjë të drejtë. Ne bëmë një shpallje të njëkohshme të veçanta, me dekrete të veçantë edhe pse dokumentet që kanë ardhur janë pothuajse të njëjtë. Duhet të kthehemi pak në kohë në momentin kur është miratuar ky ligj dhe kur unë jam konsultuar me dy procesverbalet e Kuvendit. Realisht që atëherë por edhe tani më forcohet bindja që kjo dispozitë e ligjit nuk do të thoshja është antikushtetuese, por nuk është se i jep zgjidhje shteruese problemit. Edhe nga diskutimi që është bërë nga dy ekspertët e nivelit të lartë, edhe z. Sadushi, nuk kanë shkuar në argumentimin pse është vendosur dhe a qëndron plotësisht. Mekanizmi se si do të realizohet cedon tërësisht sepse do të duhej se me anë të parashikimit ligjor të përcaktohej jo vetëm detyrimi i Këshillit, por edhe detyrimi fillimisht i organit të emërtesës që kur të shpallte vakancën të diktonte që kjo është për magjistrat. Kjo nuk është dhe kjo e sjell Këshillin në vështirësi në këto momente. Kështu që ligji këtu nuk parashikon gjithçka.

Janë krijuar vakanca të njëhershme për Këshillin, të njëkohshme për organin e emërtesës. Këto ligje janë miratuar në tetor 2016 dhe në këtë moment, edhe Kuvendi edhe Komisioni i Reformës i dinte shumë mirë vakancat që do t'i krijoheshin në 2016-ën që krijohej një, në 2017, 2019, 2022. Po aq shumë mirë e dinte sepse para këtij ligji ishte miratuar ai i vetingut që pasoja mund të kishte dhe për Gjykatën Kushtetuese. Unë si organ emërtese vlerësoj që vakancat janë të njëkohshme në momentin që ato janë shpallur. Ky detyrim nga kjo dispozitë nuk lind as për vakancën e tretë të parakohshme dhe as për të katrën që është e plotë që është shpallur tashmë. Ne prezumojmë që Këshilli, jo ky Këshill, po ai që kaloi, duhet ti kishte zgjidhur këto probleme në dy vakancat e tjera brenda 10 ditëve dhe ato ishin të njëkohshme ndoshta. Pra për organin e emërtesës të njëkohshme janë ato që u shpallën bashkë me dekrete të veçanta dhe erdhën në një kohë këtu. Po të vazhdojmë pak më thellë dhe në parim, kam kqyrur të gjitha listat e aplikantëve që kanë ardhur këtu, të paktën për ne si organ emërtese, dhe unë

shikoj që me status magistrati janë njësoj, tek vakanca e parë 6 mos gabofsha dhe tek e dyta 6. Kanë qenë në unison gjyqtarët dhe prokurorët kanë aplikuar edhe andej edhe këtej. Pavarësisht se disa prej tyre janë ngelur në procesin veting. Në qoftë se do të kualifikoheshin të gjithë pra këtu kemi kandidatë për të rankuar dhe këtej edhe këtej. Ka po ka. Po të shkojmë te vakanca tjetër, këtu nuk ka fare gjyqtar, ndërsa në vakancën që është tani së fundmi ka vetëm një gjyqtar.

Prandaj njëkohshmëria mbizotëron për dy vakancat e para të paktën për ne si organ emërtese. Këto të tjerat jo. Tani vjen momenti që Këshilli mund të përballet edhe me një diskutim tjetër në qoftë se harton 2 lista. A mundet Këshilli t'ia diktojë organit të emërtesës që këtë listë e ke për këtë vakancë?

Kandidaturat tona janë të njëkohshme dhe kjo lidhet edhe me afatin e shqyrtimit që janë shumë të shkurtra. Ne e kemi hapur vakancën dhe e dimë kush na ka aplikuar dhe në çfarë vakance. Ne hipotetikisht mund të zgjedhim si këtej si andej dhe jemi në rregull se magistratët janë në të dyja listat. Atyre nuk është se i ndryshon emërtesa edhe pse ia shkurton mandatin që ai ka preferuar të emërohet. Unë po shtroj argumentet vetëm se do të ishte në diskutim për Këshillin nëse për këto 3 vakanca, duke zbatuar edhe këtë parashikim të ligjit, do të hartohet një listë me gjyqtar dhe një listë me jogjyqtar të vlefshme për tu diskutuar apo do të renditen siç ju thoni, në secilën vakancë siç kanë aplikuar dhe të jetë organi i emërtesës që ka detyrimin të përzgjedhë dhe të ruaj balancën profesion gjini. Imagjinoni një organ emërtese pasiv që nuk shprehet.

Lidhur më problemin e formulimit të dispozitës së ligjit Presidenti nuk ka Gjykatë Kushtetuese ku ta dërgojë. Përfaqësuesit e Kuvendit duhet të ishin këtu ta dëgjonin dhe ndoshta do ta kapnin kohën që ta dorëzonin në Kuvend. Unë do të kërkoja edhe një mendim të EURALIUS-it tek kjo çështje.

Agnes Bernhard merr fjalën dhe parashtron se duket që nga diskutimi se kuadri ligjor nuk është i qartë dhe nxjerr pyetje. Kemi identifikuar të njëjta pikëpyetje që u përmendën deri tani. Në qoftë se i referohemi interpretimit gjuhësor nga pikëpamja kushtetuese atëherë kemi problem sepse diskrecioni i jepet organit të emërtesës që nga tre listat të zgjedhe tre kandidatë dhe nëse organi i emërtesës merr dy lista me nga tre kandidate atëherë kjo e ngushton diskrecionin. Nëse organi i emërtesës nuk vepron, atëherë kandidati tjetër i tretë nuk emërohet asnjëherë sepse sipas kushtetues automatikisht do zgjidhet i pari dhe nuk ka në liste të tretë. Duhet pasur parasysh edhe pritshmëria e kandidatit, edhe organin e emërtesës, ashtu edhe mandatin për të cilin ai kandidon sepse ata që kanë aplikuar, i kanë shprehur preferencat e tyre për disa nga pozicionet por jo për të gjitha. Dmth nuk ka diskrecion Këshilli që ti thotë ti në fakt ke aplikuar për mandatin 9 vjet por hiqesh nga ky mandat dhe tani duhet të kandidosh për këtë

mandatin 3 vjeçar. Kemi dy lloj interpretimesh. E para shikon si dispozitë tranzitore kalimtare dhe kjo është një rrugëdalje, përpjekje, për te arritur një interpretim. Gjithashtu kemi dhe zgjedhjen tjetër me afatgjatë dhe është një zgjidhje më e qëndrueshme që mund të shërbente si përpjekje për një interpretim në frymën kushtetuese.

Do tju tërhiqja vëmendjen për një aspekt tjetër që është e parashikuar në ligj. Në nenin 7/b është paragrafi 3, që KED brenda 10 ditëve përpilon një listë përfundimtare dhe pastaj fjalja tjetër flet për dy lista të tjera të veçanta. Ndërsa fjalja tjetër përsëri përmend listat, pra është një liste e cila do të shoqërohet me një raport të arsyetuar. Në fillim edhe paragrafi i katërt përsëri flet për një liste dhe pastaj shprehet që nëse Presidenti nuk e emëron kandidatin brenda 30 ditësh, d.m.th nga lista e paraqitur nga KED, ky kandidat i zgjedhur i pari në listë konsiderohet i zgjedhur, i emëruar. Pra, mbase ligjvënësi ka pasur parasysh që ekziston vetëm një listë. Mbase mund të shpreh edhe mendimin tim që mund të jetë thjesht pasurim i debatit që bëtë ju. KED mund të bëjë një listë të konsoliduar dhe mund të thuhet se kjo është lista e referencës për to. Nëse nuk është caktuar në emërim dhe zgjedhja e atij që është në vend të parë është e parashikuar në Kushtetute, listat e veçanta pastaj i bashkëngjiten vendimit thjesht për të qenë në pajtim me ligjin por që nuk është në pajtim me kuadrin kushtetues. Pra të dërgohet një listë për çdo vakancë, një liste e konsoliduar për çdo vend vakant për të shmangur papajtueshmëritë kushtetuese. Lista e konsoliduar do të ishte pikërisht lista që do të shërbente si referencë organit të emërtesës, ndërsa dy listat e tjera, me gjyqtare dhe jo gjyqtar, i bashkëngjiten vendimit thjesht për arsye formale. Konsideratat kushtetuese me bëjnë që tju rekomandoj të dilni me një listë konsoliduar sepse nëse do të ishin dy atëherë kjo do ishte si një kufizim për organet e emërtesës, dhe nëse organi i emërtesës nuk vepron, atëherë të kemi vetëm dy të zgjedhur.

Këshilli ndërpret diskutimet për një pushim të shkurtër.

PJESA E DYTË E MBLEDHJES

Mbledhja e Këshillit, pas pushimit, vijon me shqyrtimin dhe diskutimet rreth pikës 71 të projektaktit.

Enio Haxhimihali kërkon fjalën dhe parashtron se unë si ish nxënës i kodifikimit shikoj që jemi në një terren disi në limitet e respektimit të nenit 118 të Kushtetues, paragrafi 2, i cili thotë që “*aktet nënligjore nxirren në dhe për zbatim të ligjit*”. Pra rregulloret që po miraton ky organ dalin në zbatim të nenit 229 paragrafi 2 i ligjit, i cili parashikon që KED për të siguruar vijimin e këtij procesi transparent, publik etj etj miraton aktet nënligjore. Pra shqetësimi në institucionin tonë është të mos tejkalohet kjo gjë. Dispozita që ju konstatuat nga debati i gjatë që

u bë, edhe nga përfaqësuesi i Presidencës, ka probleme, prandaj i nderuar ju rekomanduat që, edhe pse mungon përfaqësuesi i Kuvendit i cili mund ta merrte shënim, të bëhet një plotësim ligjor. Por, për sa kohë dispozita ligjore lë vend për interpretime dhe ju diskutuat gjatë, merakujonë është të mos tejkalohen kompetencat që ligji i ka lënë këtij organi që me akt nënligjor të zgjidhen çështje të cilat ligji nuk i ka zgjidhur.

Anëtarët e Këshillit , në përfundim të diskutimeve të mëtejshme mes tyre, e kalojnë dispozitën e pikës 71 me shtesa dhe ndryshime, duke e riformuluar rastin e dërgimit të dy listave të veçanta për gjyqtarët dhe jogjyqtarët sipas përcaktimeve të ligjit. Ndërsa për gjendjen e njëhershëmrisë së proceseve të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave, veçanërisht në kushtet kur ka më shumë se dy vende vakante për secilin organ emërtese etj., nisur edhe nga problematika ligjore që shfaqin dispozitat ligjore në fuqi, Këshilli vendosi të diskutojë në vijim të shqyrtimit të dispozitave të tjera të projektaktit, edhe miratimin e një dispozite kalimtare të posaçme.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 72 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 73 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 74 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 75 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 76 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 77 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe vendosin të heqin pikën 78 të projektaktit, në kushtet kur është hequr edhe pika 66 lidhur me mekanizimin e papërshtatshmërisë nëse kandidati nuk arrin 60% të pikëve për secilën meritë.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 79 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe diskutojnë për përmbajtjen e pikës 80 të projektaktit, mbi mundësinë që për tërheqje nga kandidatura apo fakte të ngjara pas vlerësimit, organi i emërtesës të konsiderojë për përzgjedhje edhe kandidatë të tjerë në rend zbritës.

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe shprehet se nuk jam kundër por do të ngelet në diskrecionin e organit të emërtesës nëse do ta rishpalli vakancën. Pra ka të bëjë me një mundësi që mund të konsiderojë këtë zgjedhje. Kur janë në proces njëkohësisht Kuvendi po ti qëndrojnë strikt Kushtetutës duhet të presë pa e futur në seancë që Presidenti të shprehet ose jo. Presidenti do të zgjedhë i pari e thotë tre herë Kushtetuta në disa nene dhe në dispozitat kalimtare, pra e ka paramenduar që një liste mund të jetë paralele. Organet e emërtesës të qarkullojë informacionin mes tyre. Ju nuk mund të frenoheni sepse dhe juve ju mbaron afati.

Enio Haxhimihali kërkon fjalën dhe parashtron se e përsërisim idenë që shtruan edhe më parë. Kjo dispozitë nuk është në harmoni me nenin 118 të Kushtetues. Nuk mundet KED që ti tregojë një organi emërtesës çfarë të konsiderojë. Pra nuk mundet me një akt nënligjore ti përcaktojë qoftë edhe me rekomadime një organi tjetër atë që nuk ia njeh ligji.

Anëtarët e Këshillit në përfundim të diskutimeve vendosin të heqin pikën 80 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 81 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë përmbajtjen e dispozitave të Seksionit D “Publikimi i akteve të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve. Komunikata për median”.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë përmbajtjen e pikës 82 të projektaktit mbi publikimin e akteve të procedurës së vlerësimit.

Enio Haxhimihali kërkon fjalën dhe parashtron se për publikimin e akteve të procedurës së vlerësimit mungon afati i publikimit. Të ketë një afat orientues ose të përcaktohet se publikohen menjëherë.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë me disa ndryshime përmbajtjen e pikës 82 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë përmbajtjen e dispozitave të Kreut VI “Dispozita kalimtare dhe të fundit”.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë përmbajtjen e pikës 82 të projektaktit(gabimisht të numërtuar “82”).

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe diskutojnë përmbajtjen e pikës 83 të projektaktit mbi konsiderimin si burim dokumentar vlerësimi edhe gjetjet dhe përfundimet mbi vlerësimin profesional dhe integritetin e kandidatëve magjistratë sipas procedurave të ndjekura dhe vendimeve të dhëna nga ana e organeve të vetting-ut.

Enio Haxhimihali kërkon fjalën dhe parashtron se institucioni i Avokatit të Popullit e ka monitoruar procesin e vetingut dhe na rezulton se ata nuk bëjnë vlerësim të drejtpërdrejt profesional. Pra, të bazuar mbi 3 komponentët, ata marrin dokumenta nga institucionet e tjera. Znj. Tusha është nga të vetmit raste që ju kanë bërë pyetje për anën profesionale në seancë gjatë procedurës së rivlerësimit kalimtar. Shumë rrallë kanë ndodhur që ata kanë bërë vlerësimin e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë. Pra, ky nuk është burim dokumentar sepse ata nuk bëjnë vetëvlerësim. Ata marrin dokumentat nga institucionet e tjera dhe bëjnë vlerësimin e tyre mbi bazën e dokumentave që kanë prodhuar institucionet e tjera. Pra, ky organ po merr interpretimin e një organi mbi një burim që ai ka marrë. KED-ja nuk do të marrë dosjen nga K.P.K-ja do të

marri vetëm vendimin, pra, ai vendim pa dashur të paragjykojmë atë organ mund të jetë rezultat i një hetimi jo të thelluar .

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe shprehet se përtej diskutimit për konsiderimin e vendimeve të organeve të vetting-ut, Këshilli ka rënë dakort që kur një subjekt konkurren për prokuror apo gjyqtar apo kryeinspektor dhe ka një vendim të shkallës së parë (nga KPK) të vazhdojë konkurrimi. Ndërsa pyetje ime është, për ta sjellë në vëmendje se çfarë ndodh me atë subjektin që nuk e ka kaluar ende procesin dhe se mund të nxitë Këshillin që organet e vetting-ut të ecin pak më shpejt për rivlerësimin e kandidatëve. Çfarë mund të bëj ky Këshill që të mos ngelet peng i procesit të tyre. Çfarë mund të bëjnë organet e emërtesës që të nxisin veprimtarinë e K.P.K-së. A do ti bënë një shkresë K.P.K-së që të nxisoj me kandidaturat që kandidojnë këtu.

Anëtarët e Këshillit në përfundim të diskutimeve, me mendimin kundër të **Kryetarit Ardian Dvorani**, vendosën që kjo dispozitë, pika 83, të hiqet nga projektakti.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë në parim, me disa ndryshime, përmbajtjen e pikës shtesë të projektaktit sipas formulimit të propozuar nga Kryetari i Këshillit, lidhur me motivet dhe zgjidhjen kalimtare për të paraqitur në organet e emërtesës lista të vetme përfundimtare të rednities së kandidatëve për secilin vend vakant në secilin organ emërtese.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pasi merr mendimin e anëtarëve për rendin e ditës dhe kohën e mbledhjes së ardhshme, duke u përcaktuar zhvillimi i saj ditën e nesërme në datën 29 Mars, në orën 10.00, me rend dite: *Diskutimi dhe miratimi i Projektvendimit për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*, në veçanti për diskutimin mbi Shtojcat e vlerësimit dhe pikëzimit të kandidaturave, deklaron mbylljen e mbledhjes.

MBLEDHJA MBYLLET NË ORËN 20.58

Sekretare

Dorina Dulaj

Ermelinda Kadiu

Redjona Myrtja

Kryetari

Ardian Dvorani

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga personel i vetë institucioneve të ftuar.